



**REPUBLIKA E KOSOVES**  
**REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA**  
**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**OSNOVNI SUD PRIŠTINA - BASIC COURT OF PRISTINA**

---

AD/GJTHPR/01/23

Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Kryetarja e Gjykatës, Albina Shabani Rama, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga avokate T.B-B, për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtares N.K-J, bazuar në dispozitën e Nenit 9, paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafit 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 03.02.2023 merr këtë:

**V E N D I M**

Refuzohet si e pabazuar ankesa e ushtruar nga avokate T.B-B ndaj gjyqtares N.K-J për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

**A r s y e t i m**

Me datë 04.01.2023 av. T.B-B ka ushtruar ankesë disiplinore ndaj gjyqtares N.K-J në Gjykatën Themelore të Prishtinës. Me datë 06.01.2023 e njëjta ankesë me numër të protokollit 01/19 të datës 06.01.2023 është pranuar edhe përmes Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Me datë 16.01.2023 është njoftuar Këshilli Gjyqësor i Kosovës për pranimin e ankesës disiplinore të parashtrueses.

Meqenëse në të dy ankesat kemi të bëjmë me pretendime të njëjta ankimore dhe ndaj të njëjtës gjyqtare, ankesat disiplinore janë bashkuar dhe janë trajtuar si një e vetme.

Parashtruesja e ankesës av. T.B-B ka paraqitur ankesë ndaj gjyqtares N.K-J për shkak të pretendimeve se gjyqtarja në lëndën PPR.nr.1153/2022 ka treguar neglizhencë dhe nuk i ka kryer detyrat zyrtare me kohë. Ka theksuar se me aktvendimin e gjykatës së datës 02.12.2022 ndaj të pandehurit B.B është caktuar masa e paraburgimit për veprën penale “dhunë në familje”, ka shtuar se si palë mbrojtëse i janë drejtuar gjyqtares së çështjes me kërkesë për lejimin e marrjes së gjërave personale të të pandehurit me rastin e paraburgimit – sipas kërkesës së Qendrës së Paraburgimit në Hajvali që leja duhet të lëshohet nga gjyqtarja e çështjes pasi nuk ka konfiskim. Më tej në ankesë parashtruesja ka theksuar se si palë mbrojtëse i janë drejtuar me kërkesës Kryetares së Gjykatës dhe gjyqtares së çështjes për dhënien e lejes për marrjen e gjërave personale të pandehurit të cilat i janë ndaluar në Qendrën e Paraburgimit në Hajvali siç janë çelësat e veturës dhe çelësat e banesës, ngase vetura që nga arrestimi i të pandehurit gjendet para Stacionit Policor Jug, dhe ende nuk kanë marrë përgjigje.

Po ashtu në ankesë parashtruesja ka theksuar se, me datë 08.12.2022 i janë drejtuar me kërkesë Prokurorisë, ndërsa prokurori i çështjes ka kontaktuar dhe ka kërkuar që t'i lejohet familjareve të të pandehurit marrja e çelësave të veturës pasi nuk ka konfiskim dhe akoma nuk kanë marrë përgjigje nga gjykata.

Tutje, në ankesën e saj parashtruesja T.B-B ka shtuar se me datë 30.12.2022 të pandehurit kur edhe është dashur t'i përfundoj masa e paraburgimit ka kontaktuar gjyqtaren e çështjes për t'u informuar lidhur me vazhdimin ose jo të paraburgimit, dhe tek atëherë është njoftuar nga gjyqtarja e çështjes se iu është vazhduar masa e paraburgimit të të pandehurit.

Më tej në ankesën e saj parashtruesja ka theksuar se ka neglizhencë në këtë rast, sepse nga dita e arrestimi të të pandehurit nuk janë lajmëruar asnjëri nga familjarët e tij, dhe pas tri ditëve familjarët kanë marrë informatën se i njëjti është arrestuar, gjithashtu ndaj të pandehurit qëllimisht nuk i janë lejuar telefonatat, po ashtu leja për marrjen e gjërave personale nuk i është lëshuar edhe pse nga konfiskim nga ana e prokurorisë apo gjykatës. Në fund të deklaratës së saj, parashtruesja ka theksuar se, vazhdimi i masës së paraburgimit është i pabazë duke marrë parasysh që i pandehuri asnjëherë nuk ka rënë ndesh me ligjin, dhe se gjykata ka lëshuar urdhërbrojtës në afat prej 12 muajve ndaj të pandehurit ndërsa të pandehurit i vazhdohet masa e paraburgimit edhe pse është masa më e rëndë për prezencën e të pandehurit në procedurë, dhe pasi është një urdhërbrojtës gjyqtarja ka mundur të caktoj ndonjërin nga masat alternative siç është ndalimi i ofrimit të personit të caktuar apo vendit të caktuar.

Në lidhje me pretendimet e parashtruesit të ankesës, gjyqtarja N.K-J ka deklaruar se, në këtë çështje penale ka vepruar si gjyqtare e procedurës paraprake, sipas kërkesës së prokurorit të shtetit është mbajtur seanca dëgjimore dhe është marrë aktvendimi për caktimin e paraburgimit, ky aktvendim është atakuar në Gjykatën e Apelit dhe Gjykata e Apelit ka vërtetuar vendimin e kësaj gjykate. Tutje, është adresuar në IPF (Institutin e Psikiatrisë Forenzike) urdhëresa për ekzaminim të të paraburgosurit B.B dhe meqë ka munguar memorandumi i bashkëpunimit në mes të KGJK-së dhe IPF-së me kohë është njoftuar mbrojtja me këtë. Ka shtuar se, nga prokurori i shtetit është parashtruar kërkesë për vazhdimin e masës së paraburgimit. Gjykata ka vlerësuar se ende ekzistojnë kushtet e vazhdimit të paraburgimit, ngase ekziston dyshimi i bazuar se tani më i paraburgosuri B.B ka kryer veprën penale Dhuna në familje nga neni 248 të KPKS-së dhe brenda afatit ligjor është ushtruar ankesë kundër aktvendimit për vazhdimin e paraburgimit.

Tutje në deklaratën e saj gjyqtarja N.K-J ka theksuar se, sa i përket kërkesës së mbrojtëses av. T.B-B, lidhur me kthimin e çelësave të njëjtës disa herë është përgjigjur dhe atë në zyrën e saj se gjykata nuk ka asnjë provë se vetura në fjalë është sekuestruar përkohësisht dhe se depozita e të paraburgosurit qëndron në sefin e Qendrës së Paraburgimit ku i paraburgosuri mban paraburgimin dhe se për këtë çështje duhet të ushtrohet një kërkesë nga Prokurori i Shtetit.

Prokurori i shtetit me datë 17.01.2023, ka parashtruar kërkesë për kthim të çelësave të veturës dhe gjykata po te njëjtën datë ka lëshuar urdhër për dhënie të çelësave të veturës, familjareve të pandehurit.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, verifikimeve në sistemin SMIL dhe deklaratës së gjyqtares ka vlerësuar se nuk ka dyshim të arsyeshëm për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtares N.K-J lidhur me procedurën e zhvilluar dhe aktvendimit të marrë në lëndën PPr.1153/22 (2022:253548), për të cilën parashtruesja është ankuar.

Nga pretendimet e palës ankuese Autoriteti Kompetent i kësaj Gjykate vlerëson se shkeljet e pretenduara disiplinore konsistojnë në: mos kryerje të detyrave zyrtare me kohë dhe njëanshmëri për shkak të vazhdimit të paraburgimit kundër të pandehurit B.B.

Lidhur me pretendimin ankimor se gjyqtarja N.K-J nuk i ka kryer detyrat zyrtare me kohë duke mos lëshuar Urdhëresë për marrjen e gjërave personale të të pandehurit të cilat gjenden në Qendrën e Paraburgimit - konkretisht çelësave të veturës, Autoriteti i kësaj gjykate vlerëson se në rastet kur nuk ka konfiskim apo sekuestrim të sendeve, gjykata nuk mund të veproj pa kërkesën e Prokurorit të Shtetit, për më tepër nga shkresat e lëndës rezultojnë se Prokuroria me datë 17.01.2023 ka parashtruar kërkesë për kthimin e sendeve – çelësave të veturës ndërsa gjyqtarja në të njëjtën ditë ka lëshuar Urdhëresë me të cilën i lejohet A.B që t'i pranoj çelësat e veturës të të paraburgosurit – vllaut të tij B.B, andaj duke pasur parasysh që gjyqtarja ka vepruar pas kërkesës së Prokurorit të Shtetit, Autoriteti i kësaj gjykate konsideron se nuk është shkelur dispozita e nenit 5, par.2, nën-paragrafi 2.7 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Lidhur me pretendimin ankimor se gjyqtarja e rastit nuk e ka njoftuar mbrojtjen me kohë për vazhdimin e paraburgimit kundër të pandehurit, Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate pas analizimit të shkresave të lëndës ka gjetur se, në seancën dëgjimore të datës 27.12.2022 për vazhdimin e paraburgimit të të pandehurit B.B prezent ka qenë Prokurori i Shtetit dhe av. P.H sipas detyrës zyrtare, dhe nga kjo rezultojnë se mbrojtja është njoftuar me kohë për mbajtjen e seancës dëgjimore dhe është respektuar e drejta e të pandehurit për mbrojtje, po ashtu nga shkresat e lëndës rezultojnë se parashtruesja T.B-B aktvendimin e për caktim të paraburgimit e ka pranuar me datë 04.01.2023 dhe brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit.

Lidhur me pretendimin e parashtrueses se gjyqtarja N.K-J ka vazhduar paraburgimin për të pandehurin derisa i pandehuri ka pasur urdhërmbrojtje në afat prej 12 muajve, rrjedhimisht me këtë veprim ka qenë e njëanshme, Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate vë në pah se nuk e ka të drejtën e komentimit të aktvendimit të marrë nga gjykata përkatësisht nga gjyqtarja e procedurës paraprake, sepse për mënyrën e vendosjes së çështjes, gjyqtarët veprojnë konform ligjit, në bazë të bindjes së lirë, pa asnjë presion apo ndikim nga kushdo qoftë, bazuar në provat/shkresat e lëndës, të thënat e palëve në procedurë si dhe legjislacionit në fuqi. Në këtë drejtim, me nenin 107 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës parashihet: “Gjyqtarët, gëzojnë imunitetin nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga funksioni, për vendimet e marra, votimin e bërë, mendimin e shprehur dhe për veprimet e tjera të ndërmarra që janë brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësi të tyre si gjyqtarë”, e po ashtu parimi i njëjtë mbrohet edhe nga instrumentet ndërkombëtare ku në Deklaratën Universale mbi Pavarësinë e Gjyqtareve, ceket: "Gjykatësit gjatë ushtrimit të detyrave të tyre duhet të jenë të lirë për të vendosur mbi çështjet në mënyrë të paanshme, në përputhje me vlerësimin e tyre të lirë të fakteve dhe të kuptuarit e tyre të ligjit”.

Gjithashtu, Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate gjen se për aplikimin e gabuar të së drejtës materiale apo procedurale nga ana e gjyqtarëve gjatë punës së tyre, mund të jetë shkak për ushtrimin mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme në gjykatat e instancave më të larta nga pala e pakënaqur por nuk mund të konsiderohet shkelje disiplinore. Për më tepër, Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate vëren se, Gjykata e Apelit me aktvendimin PN1DP.nr.63/2023 të datës 18.01.2023, e ka shqyrtuar ankesën e mbrojtjes lidhur me vazhdimin e paraburgimit me ç’rast nuk ka gjet shkelje procedurale dhe ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Andaj, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me ankesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkruara më lartë, vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtarja N.K-J ka kryer shkelje disiplinore, për t'i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të Rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

AD/GJTHPR/01/23, me datë 03.02.2023

Albina Shabani Rama

---

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë